



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 72, DATË 03.09.2020

**PËR SHTYRJEN E VENDIMMARRJES
PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË BREZIT HF,
PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT AUDIO” DHE VENDIMIT “PËR NJË SHITESË NË
VENDIMIN NR. 220, DATË 01.12.2017 “MBI PËRCAKTIMIN E PAGESAVE PËR
LICENCË/AUTORIZIM DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA AUTORITETI I
MEDIAVE AUDIOVIZIVE”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për miratimin e projektregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie e autorizimit për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio” dhe vendimit “Për një shtesë në vendimin e AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”

. Bazë Ligjore: Neni 19, pika 16 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

VËREN SE:

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbledhjen e tij të datës 03 shtator 2020, mori në shqyrtim relacionin dhe projektvendimin:

- Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie e autorizimit për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio”
- Për miratimin e vendimit “Për një shtesë në vendimin e AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”

Disa nga anëtarët e AMA-s propozuan shtyrjen e votimit për miratimin e këtyre dy akteve, duke pretenduar se afati prej 48 orësh, nuk ka qenë plotësisht i mjaftueshëm për t’u njohur me përmbajtjen e projektakteve të mësipërme.

Në përfundim, anëtarët e AMA-s ranë dakord në mënyrë unanime të shtyjë diskutimin dhe vendimmarrjen për projektvendimin “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e autorizimit për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio” dhe projektvendimin “Për një shtesë në vendimin e AMA-s nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”,

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të shtyjë vendimmarrjen për projektvendimin “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e autorizimit për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio” dhe projektvendimin “Për disa shtesa në vendimin e AMA-s, nr. 220, datë 01.12.2017 “Për miratimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA